

UDHËZIM
Nr.12/1, datë 26.5.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.12, DATË 18.5.2011 “PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.10418, DATË 21.4.2011 “PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor””, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në sesionin II. 4 “Falja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në pikën 2 “Personat fizikë dhe juridikë”, fjalët “...me kushtin që kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguhen brenda afatit të zbatimit të ligjit” shfuqizohen.

2. Në sesionin III “Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1.4 ndryshohet si më poshtë:

“1.4 Aplikuesi paraqitet personalisht, me dokument identifikimi pranë ZVRPP-së dhe depoziton në dy kopje formularin e aplikimit të punonjësi i ZVRPP-së. Ky i fundit shqyrton të dhënat e plotësuar në formular dhe dokumentacionin bashkëlidhur (nëse ka). Nëse të dhënat janë të sakta, punonjësi i ZVRPP-së nënshkruan formularin e aplikimit dhe një kopje të tij ia jep aplikuesit. Nëse ka pasaktësi në plotësim, fton aplikuesin t’i korrigjojë. Punonjësi i ZVRPP-së nuk ka asnjë arsye që të refuzojë kërkesën për aplikim.

a) Tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet 1% e diferencës midis çmimit të rivlerësimit me çmimin e blerjes së pasurisë në kontratën paraardhëse të shitblerjes. Në rastet kur pasuria e paluajtshme e regjistruar në ZVRPP nuk ka një kontratë paraardhëse shitblerjeje, tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet sipas metodikës së përdorur në udhëzimin nr.9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, të ndryshuar.

Gjatë plotësimit të formularit të aplikimit për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive llogarit masën e tatimit të rivlerësimit (pika 4 e formularit të rivlerësimit). Aplikuesi paguan në bankë, për llogari të Buxhetit të Shtetit të Ministrisë së Financave, tatimin 1% të rivlerësimit të pasurisë. Tatimi mbi rivlerësimin e pasurisë duhet të paguhet në momentin e kryerjes së aplikimit për rivlerësim. ZVRPP-ja, pasi bashkëlidh formularin e aplikimit për rivlerësim me mandatin e pagesës së tatimit nga aplikuesi, bën ndryshimet përkatëse brenda 10 ditëve në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Data e rivlerësimit të pasurisë është data e pagimit të tatimit të rivlerësimit të pasurisë. Ky ndryshim i njoftohet aplikuesit, sipas kërkesës së tij në ZVRPP, për shërbimin e lëshimit të kopjes së kartelës së pasurisë apo vërtetimit të pronësisë së paluajtshme.

b) Në rast se individ i do të bëjë kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme pas rivlerësimit, tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë llogaritet si diferencë e çmimit të shitjes dhe çmimit të rivlerësuar të pasurisë. Në rast se kjo diferencë është negative, individ i nuk paguan tatim.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode